



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.231/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike përkatësisht në shenja të komunikacionit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak vendosjes së posterit në hapësira publike përkatësisht në shenja të komunikacionit, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 3,200.00 (tremijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 04.10.2019, në rrugën “Fadil Hoxha”, në lagjen Kalabria në Prishtinë, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të vendosur në hapësira publike përkatësisht në shenja të komunikacionit, kështu duke është vepruar në kundërshtim me nenin 33 par.1 pika b) të LZP-së, këto pretendime vërtetohen në bazë të fotografive që i kemi bashkangjitur ankesës.

Në përgjigje në ankesë të datës 05.10.2019, subjekti politik PDK, thekson se ndaj posterit të kandidatit për deputet Mërgim Lushtaku, i vendosur në rrugën “Fadil Hoxha”, në lagjen Kalabria në Prishtinë, janë marrë masa përmirësuese duke e larguar posterin nga vendi në fjalë. Për vërtetimin e këtij pretendimi gjendet fotoja e bashkangjitur në përgjigje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga paraqitësi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik PDK, ka vendosur posterin e kandidatit të tyre Mërgim Lushtaku, në hapësirë publike përkatësisht në shenja të

komunikacionit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik kanë qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, sepse ka marr pjesë në zgjedhjet e mëhershme;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër, PZAP-i, e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësia për t’u përgjigjur, madje i njëjti subjekt ka vepruar drejtë përmirësimit të shkeljes sepse ka larguar posterin në fjalë, veprim ky i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me anë të këtij vendimi respektivisht gjobës së shqiptuar paneli synon të ndikon te subjekti politik që në të ardhmen ky subjekt mos t’i përsërit veprimet e njëjta apo veprime tjera të cilat bien ndesh me ligjin.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.231/2019 më datën 05.10.2019

Kryesues i Panelit

Faton Ademi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 të LZP-së.*

